



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data

07.12.2020

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR CAKTIMIN E NJËSIVE ADMINISTRATIVE KU DO TË KRIJOHEN SELITË E KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021”

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “b” dhe “n”, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen Selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 6, datë 30.11.2020 “Për miratimin e ngritjes së Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”, miratoi ngritjen e 92 (nëntëdhjetë e dy) Zonave të Administrimit Zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

Referuar juridiksionit territorial të secilës prej Zonave të Administrimit Zgjedhor që do të funksionojnë për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, duke analizuar dhe vlerësuar:

- shtrirjen dhe relievin gjeografik të Zonave të Administrimit Zgjedhor;
- numrin dhe pozicionin gjeografik të njësive administrative të përfshira në territorin e Zonave të Administrimit Zgjedhor;
- lehtësitë logjistike të transportit rrugor;
- praktikat e zgjedhjeve të mëparshme;

njësitë administrative të përcaktuara në Lidhjen 1 të projektvendimit, ofrojnë barazlargësi nga qendrat e votimit në juridiksion e ZAZ-së përkatëse, dhe lehtësi logjistike të transportit rrugor, duke ofruar kushte optimale për të krijuar Selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor që do të ngrihen për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

Ana TENOLLI – Drejtorja e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore

Madalena KOJA – Drejtorja Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor

Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm

